

KLSH MERR PJESË NË WORKSHOP-IN “IMPLEMENTIMI I STRATEGJISË DHE RAPORTIMI”, ZHVILLUAR NGA IDI

Në kuadër të nismës së IDI-t “Strategjia, Matja e Performancës dhe Raportimi (SPMR)”, në datat 6 – 10 shkurt 2023 u zhvillua në Stamboll workshop-i mbi implementimin e strategjisë dhe raportimin, ku morën pjesë dy audituese të KLSH-së, znj. Xhuljeta Celaj dhe znj. Miranda Misini.

Objektivat kryesore të workshop-it ishin njohja e pjesëmarrësve me parimet moderne të implementimit të strategjisë dhe raportimit, inkurajimi i shkëmbimit të eksperiencave dhe identifikimi i mënyrave për të përmirësuar më tej praktikën e menaxhimit strategjik të SAI-t.

Ky workshop është organizuar në vijim të mbështetjes që IDI i ka dhënë KLSH-së për kryerjen e vlerësimit sipas kornizës së matjes së performancës së SAI-eve, për hartimin e strategjisë institucionale dhe finalizimin e planit operacional për këtë strategji. Me këtë aktivitet mbyllet cikli i mbështetjes që IDI i ka ofruar jo vetëm KLSH – së por edhe SAI – ve të tjera pjesëmarrëse lidhur me të gjitha fazat e planifikimit strategjik, matjes së performancës dhe raportimit.



Gjatë diskutimeve, trajnerët e IDI paraqitën kornizën teorike për hartimin e planit operacional dhe raportimit. Pjesëmarrësit gjithashtu prezantuan punën e kryer për hartimin e planit operacional dhe sfidat lidhur me të. KLSH gjithashtu paraqiti draftin e planit operacional dhe pati diskutime të gjera me përfaqësuesin e IDI – t, z. Laurent Grosse – Kozłowski i cili ka ndjekur gjithë zhvillimin e kësaj iniciative në KLSH duke nisur që nga SAI PMF. Komentet dhe sugjerimet e IDI – t do të pasqyrohen në draftin final të planit operacional.

Pjesëmarrës në këtë aktivitet ishin 18 përfaqësues nga 9 SAI - Aruba, Kosova, Mauritius, Mali i Zi, Namibia, St. Lucia, Turqia dhe Zambia.